



**Advocacy Center**  
for **Democratic Culture**

**QERSHOR**  
**2023**

# BULETINI

Nëpërmjet një sërë konferencash, diskutimesh dhe ngjarjesh, OJQ ACDC në qershor ka punuar në mënyrë aktive drejt promovimit të të drejtave të njeriut, luftës kundër diskriminimit dhe avokimit për drejtësi në Kosovë.



## **KONFERENCA PËR TRAJTIMIN E DISKRIMINIMIT NË KOSOVË**


Më 8 qershor, në Prishtinë, OJQ ACDC organizoi konferencën me fokus në adresimin e çështjes së diskriminimit në Kosovë. Panelistët përfshinin Frank Power, Shef i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Art Vula, Koordinator i Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut (YIHR) dhe Dushan Radakovic, Drejtor Ekzekutiv i ACDC.



Gjatë ngjarjes, Dushan Radaković prezantoi hulumtimin mbi Diskriminimin në Mitrovicën e Veriut, të kryer nga ACDC në prill të vitit 2023. Analiza kishte për qëllim adresimin e çështjeve të diskriminimit në Mitrovicën e Veriut dhe ofroi njohuri mbi perceptimet e qytetarëve dhe njohuritë e legjislacionit ekzistues kundër diskriminimit.

**SRB** **ALB** **ENG**

Të pranishmëve i'u drejtua edhe zëvendëskryeministrja e Kosovës, Emilija Rexhepi, e cila theksoi rëndësinë e luftës kundër diskriminimit, dënimit e gjuhës së urrejtjes dhe nxitjen e zhvillimit të një shoqërie në harmoni.



Konferenca u organizua në kuadër të projektit "Promovimi i të drejtave të njeriut dhe parimeve të mosdiskriminimit në nivel lokal, i zbatuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe i mbështetur nga UNMIK-u.



Mbulimi medial i konferencës:





## KONFERENCA MBI POZITËN E GRAVE SHTATZËNA DHE NËNAVE TË REJA

Konferenca për përmirësimin e pozitës së grave shtatzëna dhe nënave të reja u organizua në Shtëpinë e BE-së në Mitrovicën e Veriut më 27 qershor 2023. Panelistët ishin Gordana Gjoriq, Presidente e Shoqatës së Grave të Biznesit "Avenija" dhe Ines Aljović Mihajloviq, Zyrtare e Programit në ACDC. Ngjarja paraqiti një hulumtim të hollësishëm të kryer nga OJQ ACDC, duke theksuar sfidat me të cilat përballen gratë shtatzëna dhe nënat e reja, si dhe duke theksuar rëndësinë e mosdiskriminimit në ligjet e punës. Konferenca u organizua në kuadër të projektit "Avokimi për një pozitë më të mirë të grave shtatzëna dhe nënave të reja", i zbatuar nga OJQ ACDC.

## GJYKIMI I SIMULUAR NË SEANCË GJYQËSORE

Më 26 qershor, praktikantët e përfshirë përfunduan praktikën e tyre tre mujore me një simulim të seancës gjyqësore. Pavarësisht pamundësisë për të mbajtur simulimin në një sallë të vërtetë gjyqi, siç ka qenë praktikë në vitet e mëparshme, ACDC arriti të kryejë simulimin përfundimtar që ofroi përvojë të vlefshme praktike për të rinjtë e diplomuar në drejtësi.

Programi i praktikës është pjesë e projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe të Kosovës", financuar nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL), dhe zbatuar nga OJQ ACDC në partneritet me OJQ AKTIV.





## Podcast mbi diskriminimin

Radio Kontakt Plus publikoi një episodë podcast, në kuadër të projektit të kryer nga ACDC dhe financuar nga Këshilli i Evropës.

Në episodë, Milica Radovanoviq nga Iniciativa e Re Sociale ndau pikëpamjet mbi diskriminimin e gjatë dhe sistemet jofunksionale me të cilat përballen qytetarët nga veriu i Kosovës.



## Barazi për të gjithë

Në përputhje me këtë, ACDC zbatoi fushatën e ndërgjegjësimit që përfshinë realizimin e broshurave, me qëllim të informimit dhe fuqizimit e qytetarëve duke theksuar rëndësinë e luftimit të diskriminimit dhe promovimin e unitetit dhe solidaritetit për të nxitur një shoqëri gjithëpërfshirëse pa diskriminim.



## Qasje e Barabartë në Drejtësi

Në qershor, ACDC publikoi një video për të rritur ndërgjegjësimin për domosdoshmërinë e qasjes të barabartë në drejtësi dhe për të promovuar parimet kryesore që e mbështesin atë.



## DISKUTIM PËR TRAJTIMIN E POPULLATËS SERBE



INë përgjigje të krizës së vazhdueshme politike dhe përshkallëzimit të tensioneve në veri të Kosovës, OJQ ACDC mori masa për trajtimin e popullatës serbe nga forcat speciale policore në veri të Kosovës dhe organizoi një diskutim me z. Naim Qelaj, Avokat i Popullit të Kosovës.

Diskutimi mbledhi së bashku aktivistë dhe përfaqësues nga organizata të ndryshme të cilët shprehën shqetësime të thella rreth arrestimeve arbitrare, keqtrajtimit të individëve, rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe deklaratave provokuese të bëra nga figura politike, të cilat të gjitha kanë kontribuar në ndjenjën mbizotëruese të destabilitetit në rajon.

Në fokus të diskutimit ishte nevoja emergjente për adresimin e këtyre çështjeve urgjente dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete për të siguruar mirëqenien dhe mbrojtjen e qytetarëve që jetojnë në veri të Kosovës.

## APELI PËR PAQE

Për më tepër, ACDC, së bashku me Inter, Iniciativa e Re Sociale, Aktiv, u hartua apeli për paqe, të miratuar nga 160 serb të Kosovës, duke shprehur shqetësimin për masat represive nga qeveria e Kosovës dhe forcat speciale të policisë.

Në letër theksohet se e ardhmja e Kosovës dhe ruajtja e paqes në rajon varet nga vendosmëria dhe shpejtësia e veprimeve të ndërmarra nga bashkësia ndërkombëtare dhe vendet që e kanë njohur Kosovën.

SRB

ALB

ENG

OJQ ACDC gjithashtu nënshkroi një deklaratë për medie duke dënuar sulmet e fundit ndaj mediave serbe dhe shqiptare në veri të Kosovës.

SRB

ALB

ENG

# MBËSHTETJE E MËTUTJESHME PËR QASJEN NË DREJTËSI DHE TË DREJTAT E NJERIUT NË RAJONIN E MITROVICËS

## DHURIMI I PAJISJEVE DHE RINOVIMI I SALLËS SË GJYQIT

Në kuadër të projektit të financuar nga UNMIK-u, OJQ ACDC dhuroi pajisje teknike të IT-së për Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicën Veriore dhe Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Pajisjet u dorëzuan në prani të përfaqësuesve të UNMIK-ut nga seksioni i drejtësisë, duke përfshirë shefin e seksionit të drejtësisë Andrea Lako.



Për më tepër, në kuadër të të njëjtit projekt, një sallë e re e gjyqit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është rinovuar plotësisht, mobiluar dhe pajisur. Dhurimi dhe rinovimi janë pjesë e aktivitetit të vazhdueshëm programor të UNMIK-ut, i cili i kushtohet avancimit të efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

## RAISING AWARENESS OF HUMAN RIGHTS IN ROMA MAHALA

Më 14 qershor, OJQ ACDC, me mbështetjen e UNMIK-ut, organizoi ngjarjen në Qendrën Mësimore në Lagjen Rome, të Mitrovicës së Jugut, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së banorëve për të drejtat e tyre, ku u theksua roli i Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në promovimin e të drejtave të njeriut.



Projekti "Mbështetja e mëtutjeshme për qasje në drejtësi dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Mitrovicës", kishte për qëllim përmirësimin e qasjes në drejtësi, fuqizimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe promovimin e rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit në rajonin e Mitrovicës.

# Projekti i ri

ACDC ka filluar projektin e ri të titulluar "Fuqizimi i perspektivës së të drejtave të njeriut nga këndvështrimi jo-shumicë". Projekti synon të fuqizojë të rinjtë nga komunitetet joshumicë në veri të Kosovës duke promovuar pjesëmarrjen aktive dhe duke integruar vlerat e të drejtave të njeriut në arsim.

Projekti mbështetet nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit, përmes programit HumanRightivism, financiar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – Sida.

Në kuadër të kësaj iniciative, OJQ ACDC ka lansuar një thirrje publike duke ftuar të rinjtë e shkollave të mesme ose të universiteteve të interesuar për të drejtat e njeriut, që të marrin pjesë në trajnime që synojnë rritjen e të kuptuarit dhe angazhimin e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

## Pjesëmarrja në Ngjarje: Avancimi i të Drejtave Gjuhësore

Dusan Radakovic, Drejtor Ekzekutiv i ACDC dhe Aleksandar Rapajic, Drejtor i Programit, morën pjesë në ngjarjen që shënoi përfundimin e projektit "Përparimi i të Drejtave Gjuhësore në Kosovë" i financuar nga UNMIK-u dhe i zbatuar nga IOM. Ngjarja u fokusua në gjetjet e hulumtimit dhe udhëzimet e reja të hartuara për zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.



## ACDC në Media

Dushan Radakovic për Al Jazeera Balkan, foli për arrestimet e reja në veri të Kosovës



Aleksandar Rapajic për N1, foli për krizën në veri të Kosovës



## OP-ED-ët për të drejtat e njeriut

Në qershor, ACDC botoi dy op-ed mbi të drejtat e njeriut.

Danica Kompiroviq, MA në Drejtësi, dha një shpjegim gjithëpërfshirës të ndihmës juridike falas dhe theksoi rëndësinë e Agjencisë së Kosovës për Ndihmë Juridike Falas në avancimin e të drejtave të njeriut dhe qasjen në drejtësi,

**Roli i ndihmës juridike falas në realizimin e të drejtave të njeriut në Kosovë**

“Duke ofruar ndihmë juridike për ata që kanë nevojë, Agjencia ka një kontribut pozitiv në realizimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Është e rëndësishme të mbështetet zhvillimi i vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë qytetarët të kenë qasje të barabartë në drejtësi. Vetëm përmes një ndihme ligjore të tillë gjithëpërfshirëse dhe të qasshme mund të ndërtojmë një shoqëri që respekton dhe promovon të drejtat e njeriut.”

**Danica Kompirović**  
Magjistre e Juridike

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

ndërsa Nevena Vulović, MA në Inxhinieri Mjedisore, theksoi rolin vendimtar të mjedisit, ndërgjegjësimin për arritjen e të drejtës për një jetë të shëndetshme, veçanërisht duke adresuar ekzistencën e deponive në veri të Kosovës.

**Mbrojtja e natyrës për një të ardhme më të mirë: Roli i ndërgjegjësimin mjedisor dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut**

“Ndërsa diskutimet për të drejtat e njeriut janë gjithnjë e më të përhapura, fokusi në realizimin e tyre aktual duket se po zvogëlohet. E drejta më themelore e njeriut është e drejta për një jetë të shëndetshme, pasi vetëm një individ i shëndetshëm mund të përjetojë lumturinë. Në epokën e inovacioneve teknologjike, ku gjithçka që mund të imagjinohet është në majë të gishtave tanë, njerëzit po shkaktojnë pa dashje ndotje mjedisore dhe çrregullojnë ekuilibrin natyror, duke vazhduar drejt pasojave të rëndësishme.”

**Nevena Vulović**  
Master i Inxhinierisë së Mjedisit

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## Marking International Days

ACDC shënoi Ditën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ditën Botërore të Refugjatëve, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe mbështetjen e refugjatëve në mbarë botën.

